



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjiut për Inspeksionin Komunal

Viti, 25 maj 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Inspeksionin Komunal



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Inspeksionin Komunal organizoi takim e radhës së Kolegjiut i cili u mbajt me 25 maj 2011 në Restorantin "Lindi" në Viti. Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Drejtorive Komunale për Inspeksion dhe përfaqësues të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për Inspeksion z. Bajram Beqiri.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

1. Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut
2. Pjesëmarrje në Grupet Punuese për Ligjet relevante
3. Diskutim-Propozime për ndryshim të Ligjit për Inspektoratin e Tregut
4. Prezantim nga Drejtori i Inspektoratit të Komunës së Vitisë rreth procedurave për plotësim të dokumentacionit të nevojshëm

PËRMBLEDHJE

z. Bajram Beqiri, Kryesues i Kolegjiut përshëndeti pjesëmarrësit në takim dhe falënderoj zyrtarët e Asociacionit të Komunave të Kosovës për ndihmën e dhënë në organizimin e punës së Kolegjiut. Në këtë mbledhje pritet që Kolegjiut të plotëson Kryesinë dhe të identifikoj pjesëmarrësit potencial në grupet punuese qeveritare në procesin legjislativ, dhe po ashtu Drejtori i Inspektoratit të Komunës së Vitisë do të bëjë një prezantim i cili do të përcillet me një vizitë bizneseve në Viti.

1. Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut

z. Beqiri: sqaroi se ka mbetur një vend i lirë në Kryesinë e Kolegjiut pasi z. Cena nuk është më anëtarë, i cili do të ishte mirë të zëvendësohet nga Drejtori i ri i Komunës së Rahovecit i cili është prezent këtu sot, kështu që të vazhdohet me përfaqësim të së njëjtës komunë dhe rajon.

z. Shemsedin Maksuti Drejtor i inspeksionit – Skënderaj: kërkoi që të rishikohet edhe ndërrimi i anëtarit tjetër të kryesisë Arsenijević duke marrë parasysh se nuk ka marrë asnjëherë pjesë në takime të Kryesisë dhe Kolegjiut. Do të jetë mirë nëse do të zëvendësohet nga ndonjë anëtarë tjetër nga komunat serbe të cilët do të jenë më aktiv.

Me shumicë votash u aprovua propozimi i Kryesuesit që anëtarë i ri të jetë z. Shemsi Ibrahim, Drejtor i inspeksionit nga Komuna e Rahovecit. Ndërsa për z. Arsenijević u la që të diskutohet kjo çështje edhe një herë nga Kryesia ku do të kontaktohet nëse është i gatshëm të merr pjesë aktive në proces; në të kundërt do të zëvendësohet nga ndonjë anëtarë i ri nga komunat serbe.

2. Pjesëmarrje në Grupet Punuese për Ligjet relevante

z. Beqiri: tregoi për rëndësinë e pjesëmarrjes në grupet punuese për ligjet relevante të cilat prekin interesat e komunave. Në takim me zyrtarët ligjor të Kryeministrit dhe Ministrive na është premtuar pjesëmarrja jonë në takimet e grupeve punuese sipas strategjisë legjislative për vitin 2011. Përfaqësimi

jonë duhet të jetë si një mjet në mbrojtje të interesave komunale. Ky proces është i mirëpritur që të mos përsëritet i njëjti gabim sikurse ai për ligjin e inspektorëve të tregut kur ndryshimet u bënë pa asnjë konsultim adekuat me inspektorët e komunave. Andaj duhet të marrim pjesë në këto grupe punuese dhe të japim kontributin tonë në këto procese të rëndësishme.

z. Shefik Sylejmani, Drejtor i inspeksionit - Viti: është tepër me rëndësi që këto projektligje të diskutohen me komunitetin, të cilat janë pengesë në fushën e inspeksionit, dhe që të kemi mundësi të shprehim mendimet tona për ndryshimet e mundshme tek inspektorët e tregut apo të ambientit.

z. Nazmi Gashi, Kryeinspektor – Obiliq: deri më tash puna e inspektorëve është anashkaluar prej shumë palëve si komunale dhe qeveritare, andaj pjesëmarrja jonë në këto grupe është e nevojshme për të bërë ndryshimet e përshtatshme për punën tonë. Mirëpo duhet të zgjedhën personat e duhur dhe profesional të cilët do të jenë aktiv në këto procese legjislativ.

z. Adem Aliu, Inspektor – Ferizaj; dëshiroj të di se sa do të jenë efikase këto takime kur nuk merren parasysh asnjë sugjerim apo vërejtje e jonë për ndryshim.

z. Shemsi Ibrahim, Drejtor i inspeksionit – Rahovec: duhet patjetër të sqarojmë dallimet sa i përket punës së inspektorëve në mes të komunave dhe qendrës, sepse kemi ndeshje të interesave në mes dy palëve. Konkretisht gjendja e shfrytëzimit të zhavorrit është kritike sepse u është dhënë leje për shfrytëzim firmave të ndryshme por nuk u është përcaktuar se ku është vendi i punës, me këtë rast ata me leje qendrorë e kanë të lirë të shfrytëzojnë zhavorrin në të gjitha vendet pa asnjë kriter. Duhet po ashtu të kemi në fokusin tonë edhe projektligjin për inspektoratin e mjedisit dhe ujërave. Realisht përballemi me probleme të shumta pasi jemi zhveshur prej kompetencave tona.

Si përfundim u la që edhe njëherë gjatë konsultimeve të Kryesisë të vendoset në përcaktimin e personave të përshtatshëm të cilët do të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e komunave në këto grupe punuese për projektligjet në fjalë.

3. Diskutim-Propozime për ndryshim të Ligjit për Inspektoratin e Tregut

z. Beqiri: shpjegoj para inspektorëve se ligji mbi inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, tashmë është në fuqi, ku edhe parashihet që inspektorët e tregut do të kalojnë në MTI. Sipas disa konsultimeve nga qeveria parashihet edhe heqja e lejeve të punës si masë për lehtësimin e biznesit. Kryetari i AKK-së ka kërkuar që ky ligj të ndryshohet. Njëjtë edhe unë kam kundërshtuar këtë ligj sepse me këtë komunitetin do të varfërohen; inspektorët nuk do t'i raportojnë Kryetarit për punën e vet por do të raportojnë direkt në ministri. Si Kryesues kam kërkuar të ndryshohet ky ligj por do të jetë shumë e vështirë një gjë e tillë, andaj do të ishte mirë të kërkojmë që të bëhen disa ndryshime përmes udhëzimeve administrative. Ne patjetër duhet të gjejmë një formulë të përbashkët nga niveli qendror dhe ai lokal i cili i përshtatet funksionimit sa më të mirë të punës së inspeksionit.

z. Sylejmani: kërkoj që inspektorët duhet të kryejnë punët në respektim të ligjit; shumë inspektorë merren me punë jashtëligjore, sepse nuk kanë eprorë të cilët mbikëqyrin punën e tyre. Është mirë të mos ketë detyra të tjera jashtë përshtatimit të punës sepse nuk janë të gjithë sektorët të mbuluar nga

fusha e inspeksionit. Për më tepër nuk ka pasur koordinim në mes të nivelit qendror dhe atij lokal edhe si rezultat nuk ka pasur qarkullim të mjaftueshëm të informacionit. Deri më tash niveli qendror nuk ka kryer konsultimet e duhura; autoriteti duhet të jetë sa më afër komunës sepse autoritete lokale i dinë më mirë problemet lokale. Prandaj komunat duhet të kenë qasje në punën e inspektorëve, ndërsa roli dhe përgjegjësisë e inspektorëve duhet të jenë ndaj komunës dhe jo vetëm ndaj nivelit qendror.

z. Hetem Mustafa, Shef sektori – Ferizaj: është mirë të respektohet puna e inspektorëve nga vetë Drejtorët, do të duhet të ketë unifikimin të koeficientit të punës, si dhe të paguhet rrezikshmëria e punës sepse inspektorët çdo ditë ballafaqohen me kërcënime të ndryshme.

z. Beqiri: ne kemi adresuar rekomandimet tona ku kemi kërkuar beneficionet për rrezikshmërinë në punë, si dhe unifikimin e koeficientit, pagat më të larta, përcaktimin e detyrave, etj. Me këtë rast duhet të sqaroj se jemi organ këshillëdhënës, ne rekomandojmë për ndryshimet e mundshme Kryetarët e Komunave dhe ministrinë. Se sa përfillen ato kjo është një çështje tjetër.

z. Ibrahim: duhet të kemi të qartë se puna jonë duhet të jetë mbrojtja e qytetarit, sepse nëse ndodh që të helmohen qytetarët adresa kryesore për përgjegjësinë e këtij rasti do të jetë ajo e Kryetarit. Andaj puna e inspektorëve duhet të jetë përgjegjësi komunale. Kemi probleme të shumta me inspektorë nga fushat e tjera të cilët janë në përgjegjësi direkt të ministrive dhe askush nuk jep përgjegjësi për punën e tyre. Nuk kam asnjë kundërshtim nëse përveç inspektorëve komunal kemi edhe ata rajonal apo qendror.

z. Muhamet Gashi, Drejtor i inspeksionit – Prishtinë: heqja e inspektorëve të tregut nga përgjegjësia e komunës do të godas më së shumti kryeqytetin, ku do të shkakton probleme të shumta në aplikimin e rendit dhe funksionimin e mirë të punës së inspeksionit. Prandaj është me rëndësi jetike që këta inspektorë të tregut të mbesin në përgjegjësi të komunës.

z. Aliu; duhet ta bëjmë me dije se asnjë konkluzë e jona nuk ka kaluar deri më tash dhe nuk është respektuar. Duhet të kemi të qartë se ky ligj është në respektim të standardeve evropiane prandaj nuk ka arsye që të dalim kundër këtij ligji por ta pranojmë ashtu si është sepse po ashtu me këtë ligj do të bëhet edhe unifikimi i koeficientit për inspektorët.

z. Beqiri: theksoj se ligji i ri nuk është i keq por është i pakapshëm dhe ka implikime buxhetore për komunat. Centralizimi i kompetencave të inspektoratit të tregut zvogëlojnë të hyrat komunale, andaj është me rëndësi që bashkëpunimi me ministrinë të vazhdoj por jo të kalojnë të gjitha kompetencat e inspektorëve në ministri. Do të ishte mirë që përmes akteve normative të tejkalohet kjo gjendje në mes komunave dhe ministrisë rreth kompetencave të inspektorëve komunal.

z. Bujar Nerjovaj, Drejtor i inspeksionit – Prizren: shtoj se gjithmonë nga qeveria flasin për decentralizimin e kompetencave por në anën tjetër shkojmë drejt një centralizimi të punëve, prandaj është mirë të bëjmë me dije se duhet të respektohet funksionimi dyshkallësh, qendror dhe ai lokal.

4. Prezantim nga Drejtorit i Inspektoratit të Komunës së Vitisë rreth procedurave për plotësim të dokumentacionit të nevojshëm

Në vazhdim z. Sylejmani në prezantimin e tij shpejtoj procedurat për plotësim të dokumentacionit të nevojshëm për aplikim të lejeve të biznesit, ku në pika të shkurta foli për format dhe procedurat nëpër të cilat kalojnë qytetarët për pajisjen me këto leje. Këto procedura përfshijnë prej kërkesës për regjistrimin e biznesit, pagesën e tarifës të përcaktuar nga komuna, formimin e komisionit për verifikim të kushteve të punës, vendimi për pranim teknik si dhe dërgimi i vendimit për pranim teknik përmes postës.

Rekomandime

- Pjesëmarrja në grupet punuese në procesin legjislativ është shtyre për t'u diskutuar në takimin e radhës së Kolegjiut
- Tejkalimi i ngërçit institucional në mes komunave dhe ministrisë rreth kompetencave të inspektorëve të tregut